




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Op. Dep.	2-D/DPK
Nr. i taq broj stranica Nr. pages	05
Nr Prot. Br Prot. Prot No.	01-4679/15
Data Datum Date	07-12-2015
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	07.12.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Zekë BARDHAJ Menaxher i zyrës së Prokurimit në Komunën e Prishtinës
CC:	z. Shpend AHMETI Kryetar i Komunës së Prishtinës
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Deratizimi i rrjetit të kanalizimit të Prishtinës "

I nderuari z. Bardhaj,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin lidhur me Tenderin " Deratizimi i rrjetit të kanalizimit të Prishtinës " me numër prokurimi 616 15 180 211, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin " Deratizimi i rrjetit të kanalizimit të Prishtinës " në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik dhe të akteve tjera nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

A r s y e t i m

Departamenti i Prokurimit në Komunën e Prishtinës ka përgatitë Njoftimin për Kontratë me titull " **Deratizimi i rrjetit të kanalizimit të Prishtinës** " me numër prokurimi: 616 15 180 211, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt. 20/07/2015. Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë kornizë të llojit të shërbimeve me vlerë të madhe.

Agjencia kundër Korrupsionit me dt.05/11/2015, ka paraqitur kërkesë për dokumentacion për këtë tender dhe me datë 06/11/2015 Autoriteti Kontraktues ka dorëzuar në Agjenci tërë dokumentacionin e kërkuar.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë aktivitet të prokurimit AKK ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim: për këtë aktivitet të prokurimit Dosjen e Tenderit e kanë tërhequr gjithsej 120 Operatorë Ekonomik, ndërsa 3 prej tyre i kanë dorëzuar ofertat e tyre për këtë kontratë.

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve të dt.03/09/2015 të gjithë OE konkurrues janë të përgjegjshëm duke i plotësuar të gjitha kërkesat e përshtatshmërisë administrative, teknike profesionale si dhe financiare ndërsa OE Ekologjia është rekomanduar si fitues me që ka edhe çmimin më të ulët. Pas rekomandimit të komisionit me datën 07/09/2015 AK-zyra e prokurimit përmes web faqes së KRPP-së publikon Njoftimin për Dhënie të Kontratës edhe sipas këtij njoftimi emri zyrtar i operatorit ekonomik të cilit i është dhënë kontrata është EKOLOGJIA me çmim prej 104,040.00€.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës të dt.07/09/2015 operatori Ekonomik N.SH.T."Doctor Exterminator D.D.D." si palë e pakënaqur më dt. 18/09/2015 ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Po në këtë datë OSHP nxjerr vendim mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit për tenderin "Deratizimi i rrjetit të kanalizimit të Prishtinës" me nr. 616 15 180 211, dhe obligon Departamentin e Prokurimit pranë AK-KK Prishtinë që brenda tre ditësh ta sjellë gjithë dokumentacionin lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Në Raportin e Ekspertit Shqyrtues të datës 29/09/2015 thuhet se : Eksperti shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit, të pretendimeve ankimore të OE ankues "Doctor Exterminator D.D.D.", sqaron se duke u bazuar në analizat dhe konstatimet e cekura më lartë, këto pretendime janë pjesërisht të qëndrueshme, andaj eksperti shqyrtues rekomandon Panelin shqyrtues që ankesën e OE ankues "Doctor Exterminator D.D.D.", ta aprovoj pjesërisht si të bazuar. Andaj mendimi i ekspertit shqyrtues është si në vijim: *Eksperti shqyrtues, gjatë analizimit të procedurës së zhvilluar për aktivitetin e prokurimit "Deratizimi i rrjetit të kanalizimit të Prishtinës", me nr. Të prokurimit: 516 15 180 221, si dhe bazuar në konstatimet dhe përgjigjet në pretendimet e cekura më lartë, i propozon Panelit shqyrtues që kë aktivitet të Prokurimit ta kthej në ri- vlerësim.*

Organi Shqyrtues i Prokurimit më datë 17/10/2015 merr Vendim mbi shtyrjen e afatit ligjor për marrjen e vendimit për aktivitetin e prokurimit “Deratizimi i rrjetit të kanalizimit të Prishtinës” me nr. 616 15 180 211, të iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës. Me arsyetimin se gjatë kësaj periudhe kohore dy anëtar të Bordit dhe një numër i ekspertëve shqyrtues po ashtu mungojnë ne pune, ndërsa ankesa e cila do të shqyrtohet nga paneli shqyrtues kërkon verifikimin e provave dhe fakteve të ndërlikuara për marrjen e një vendimi meritore, paneli shqyrtues e përcakton çështje si shumë të ndërlikuar, prandaj komfor nenit 117 paragrafi 1 të LPP-së, shtyhet afati ligjor për marrjen e vendimit për jo më shumë se njëzet (20) ditë kalendarike prej dt.17 tetor 2015.

Paneli shqyrtues në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 26/10/2015 edhe për kundër faktit se ish-in të ftuar me kohë përfaqësuesi i OE ankues dhe ai i Ak të njëjtit nuk ishin prezent dhe nuk e kishin arsyetuar mungesën e tyre as nuk kishte ndonjë kërkesë për shtyrje të seancës dëgjimore, me këtë rast paneli pasi konstatoi se ftesat ishin dërguar sipas shkresave të lëndës vendosi që seanca të mbahet pa prezencën e palëve në pajtim me dispozitat e nenit 28 të Rregullores së punës së OSHP ku ne vazhdim paneli shqyrtues bëri kontrollimin dhe analizën e materialit të këtij aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konstatoj se autoriteti kontraktues gjatë procesit të vlerësimit të ofertave lidhur me aktivitetin e prokurimit “Deratizimi i rrjetit të kanalizimit të kanalizimit të Prishtinës” ka respektuar dispozitat e LPP-së. Dhe më datë 03/11/2015 OSHP nxjerr vendim me të cilin aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.SH.T.”Doctor Exterminator D.D.D.” si dhe vërtetohet vendimi i Autoritetit Kontraktues Komunes së Prishtinës, për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Deratizimi i rrjetit të kanalizimit të Prishtinës”, me nr. të prokurimit 616/15/180/221.

Paneli Shqyrtues konsideron se mos plotësimi i identifikimit financiar nga ana e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë në formularin e dorëzimit të tenderit, komfor nenit 59 paragrafi 4 pika (i) dhe pika (ii) të LPP-së, paraqet devijim të vogël që nuk shkakton ndryshim material të kushteve dhe kërkesave tjera të parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, duke pas pasrasysh çmimin e ofruar nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të dhe çmimit të operatorit ekonomik ankues, për 80,000.00€ më i lirë është operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka analizuar me kujdes Aneksin 1 të dosjes së të tenderit që ka të bëjë me pjesën e specifikimeve teknike të detyrueshme që janë përpiluar për këtë tender ka konstatuar se në këtë pjesë Autoriteti Kontraktues nuk ka parapa një sasi të përafërt të sasisë së preparatit i cili përdoret për deratizim. Përveç përshkrimit të numrit të pusetave si dhe kilometrave që do të trajtohen, Është paraparë që në secilën pusëtë të vendoset sasi e nevojshme (270 – 360 gr) e preparatit për deratizim e cila nuk guxon të hedhet në ujë .

Agjencia ka vërejtur së tek oferta e të OE EKOLOGJIA i cili është shpallur fitues nga ana e Autoritetit Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit në metodologjinë e ofrimit të shërbimeve për deratizim është cekur se preparatet që do të përdorim për deratizim janë preparate ekologjike me materie aktive Brodifacoum të prodhuara nga Unichem- Slloveni dhe Detia nga Gjermania. Janë të paketuara në formë të blloqeve të parafinës rezistueshme nga lagështia me madhësi **100gr dhe 50 gr**. Janë të atestuara dhe të lejuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Në Pjesën A të dosjes së tenderit pika 3 në mënyrë decitive është cekur që shërbimet duhet të jenë në Pajtim të plotë me specifikimet teknike të parashtruara në këtë Dosje të Tenderit, dhe në përputhshmëri në të gjitha aspektet me vizatimet, **sasitë**, modelet, mostrat, matjet dhe udhëzimet tjera. Cilido specifikim që nuk është në përputhshmëri me specifikimet teknike do të diskualifikoj tenderin.

Lidhur me këto mospërputhje në mes të gramëve të preparatit të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe gramëve të ofruara nga ana OE Ekologjia, Agjencia ka realizuar takime me Zyrtarin Përgjegjës të zyrës së Prokurimit të Prishtinës dhe me dy anëtarët e komisionit vlerësues për të diskutuar çështjen e cekur si më lartë, sipas zyrtarëve në fjalë në treg ka preparate që përdoren për deratizim duke filluar nga 30g e tutje dhe sasinë të cilën e ka paraqitur OE fitues (100gr dhe 50gr) nuk paraqet ndonjë problem për implementimin e kontratës në fjalë, sepse varet nga gjendja faktike e puse tave pasi që ka raste kur në një puset duhet të vendosen deri në 500gr sasi të preparatit.

Si rrjedhojë e kësaj agjencia konsideron se autoriteti kontraktues është dashur që të bëjë një formulim më të qartë dhe më detal te specifikave duke përcaktuar minimumin e gramëve të preparatit si dhe të parashikoj një sasi të përafërt te preparatit që do të nevojitet për trajtimin e puse tave të përcaktuara në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Bazuar në Rregulloren për Prokurim Publik Autoritetet kontraktuese do të specifikojnë **sasitë** gjatë përgatitjes së materialeve tenderuese përfshirë publikimet, materialet tenderuese dhe kontratat. Në rast të aplikimit të kontratës kornizë ku **sasitë** mund të mos jenë parashikuar në mënyrë precize një parashikimi i përafërt i sasive duhet të përfshihet. Parashikimi i tillë i përafërt mund të bazohet në konsumin e mëhershëm duke e korrigjuar me variacionet e njohura sipas nevojës. **Sasitë** duhet të kenë për aq sa është e mundur afatet e dorëzimit.

Po ashtu tek PJESA II- LISTA E ÇMIMEVE të Dosjes së Tenderit Agjencia ka vërejtur se Autoriteti Kontraktues si çmim për njësi ka tek rubrika 1 ka paraparë KM-Sasia 170, si dhe tek rubrika 2 njësia COPE sasia 6000. Agjencia konsideron se objekt i furnizim të kontratës nuk janë pusetat por janë preparate deratizuese me të cilat do të furnizohet autoriteti kontraktues me të cilat do të bëhet trajtimi i pusetave. Për Agjencinë është fare e pa qartë mënyra e kalkulimit të çmimit për njësi nga na e OE-ve.

Sipas nenit 26 paragrafi 3 të Rregullores për Prokurim Publik vlera totale e kontratave ose vlera e parashikuar te kontratës kornizë duhet të kalkulohet në bazë të çmimeve të artikujve duke shumëzuar me **sasitë** relevante ose **sasitë** e parashikuara të përafërta.

Më tutje Agjencia ka analizuar me kujdes Dosjen e OE Ekologjia dhe ka konstatuar se tek pjesa e dosjes së tenderit mungon formulari- Identifikimi i operatorit ekonomik. Këtë pikë komisioni vlerësues nuk e ka trajtuar fare, edhe pse eksperti shqyrtues i OSHP-së i ka konstatuar pjesët që mungojnë te ky formular, veprim ky i cili konsiderojmë se bie ndesh me nenin 20 të Rregullores për Prokurim Publik. Sipas këtij neni autoritetet kontraktuese do të specifikojnë në dosjen e tenderit, formularin e tenderit që do të plotësohet dhe nënshkruhet nga tenderuesit. Formulari i tillë për tender përfshinë: **identifikimin e operatorit ekonomik**, deklarat e tenderuesit dhe specifikacionet e çmimit të tenderit. AKK mendon se mungesa e Nenit 8 dhe 9 te pjesa C- Formulari i Dorëzimit të Tenderit, si dhe mos plotësimi i pjesës së këtij formulari të IDENTIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK e bënë këtë operator ekonomik të papërgjegjshëm. Sipas Nenit 29.2 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, formulari i tenderit së bashku me të gjitha dokumentet tjera që kërkohen, të plotësuara mirë të nënshkruara përbëjnë tenderin.

Gjatë takimeve të mbajtura në Autoritetin Kontraktues- Komuna e Prishtinës, Agjencia ka kuptuar se zyrtarët nga njësia e kërkesës që kanë qenë hartues të specifikave kanë qenë anëtarë të komisionit vlerësues njëkohësisht janë propozuar edhe për menaxhimin e kontratës. Sipas nenit 9 të Udhëzuesit operativ për Prokurim Publik paragrafit 9.2 stafi i departamentit të kërkesës mundë të përcaktohet që të bëhet anëtarë i: komisionit të hapjes së tenderëve ose komisionit të vlerësimit të tenderëve, përveç personit-ëve të cilët kanë hartuar ST/TER/FES etj. Agjencia konsideron se AK- Komuna e Prishtinës duhet të ketë kujdes gjatë formimit të komisioneve që mos të përfshihen anëtarë të cilat kanë hartuar specifikat edhe në komisionet vlerësuese dhe menaxhuese.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 28 Specifikimet teknike dhe nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 si dhe nenin 20 Formularët e tenderëve dhe dorëzimi i tenderëve dhe nenin 26 Sasitë në lidhje me kontratat për mallra, punë dhe shërbime të Rregullores për Prokurim Publik, nenin 9 Funkcionet e Njesisë së Kërkesës si dhe nenin 56.3.4 Ndarja e Detyrave të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës nga organet Kompetente dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!